

EPIKA HISTORIKE KUSHTUAR LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Gëzim RREDHI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër,
SHQIPËRI

E-mail: gezimrredhi@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Një vështrim i shpejtë lidhur me trashëgiminë e epikës historike shqiptare të kësaj periudhe. Jehona në krijimet popullore e ngjarjeve të mëdha që kulmojnë me Lidhjen e Prizrenit. Informacioni i gjerë që sjellin dhe karakterizimi i sfondit historik në këto krijime. Shpërndarja gjeografike e tyre dhe motivet thelbësore. Frymëzim e lajtmotiv kryesor i këtyre krijimeve ishin idetë e Lidhjes dhe vendimet e saj. Atdheu e trojet shqiptare janë një kufi i ngulitur mirë në këngën popullore të kësaj periudhe. Tablotë dhe episodet që fikson populli në kujtesën e vet përmes këtyre këngëve janë të gjalla, plot epizëm e dramacitet. Veçori të rrëfimit në këto kënge, spontaniteti i paraqitjes, plasticiteti i narracionit, vizatimi realist, etj. Denoncimi që iu bën kënga popullore barbarive të pushtuesve të huaj dhe lakmive të fqinjëve serbo-malazezë. Vizatimi e portretizimi i situatave dramatike dhe karakterizimi i heronjve në to. Pasuria dhe larmia e këtyre krijimeve në kuadrin e gjithë trashëgimisë popullore. Kjo pasuri popullore me larminë e vet dhe gjerësinë e motiveve, përfytyrimet e bukura dhe sugjестive përbëjnë një kronikë artistike të pavdekësisë, shprehje të fatit dhe mbijetesës së popullit tonë.

Fjalë kyçe: Lidhja e Prizrenit, epika historike, shpërndarja gjeografike, tematika, poetika.



Key words: Prizren League, historical epics, geographical distribution, thematics peculiarities, poetics.

HYRJE

Epika historike që i kushtohet Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kësaj ngjarjeje fundamentale të historisë sonë kombëtare, përbën një kronikë artistike të sakrificës dhe dramës së madhe të kombit tonë në përpjekjen e vet për mbijetesë. Në këto krijime gjejmë kushtrimin e luftës, lidhjen e besës dhe jehonën e kuvendeve në shkallë kombëtare e rajonale, mobilizimin dhe heroizmin e pashembullt të popullit për mbrojtjen e trojeve stërgjyshore, por edhe një informacion të gjerë që kapërcen çdo lloj kufiri ndarës; politik, rajonal, perandorak etj. Këtë e tregon më së miri edhe gjeografia e këtyre

këngëve që theksohet që në titujt e tyre: *Atje në Shkodër u ba gazepi, Në Stamboll u mblodh mexhlisi, Hajmedet po ban Gjakova, Ku gjendet o Ergjëria, Kur ra serpi n' Prizren, Ç'u çkulë nga Manastiri, Ku bie Lëkurësi...* etj. Në këto këngë shpesh paraqiten situatë dhe fakte, që pasqyrojnë me saktësinë e kronikës personazhe e ngjarje historike, përmenden traktatë e forume ndërkombëtare si traktati i Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit, etj., mbahen qëndrime e denoncohen hapur lakmitë e fqinjëve serbë, grekë e malazezë, por edhe indiferenca dhe vendimet e padrejta të Fuqive të Mëdha.

Epika historike e kësaj periudhe paraqet gjithashtu aspekte që përfshijnë një dimension të gjerë të rrethanave historike, siç ndodh p.sh në ciklin e këngëve që pasqyrojnë situatën që para-prin ngjarjen madhore të Lidhjes së Prizrenit, ku jepet kronika e kalvarit të vuajtjeve, dramave dhe hidhërimeve të muhaxhirëve shqiptarë që shpërngulen me forcë nga trevat e ndryshme shqiptare, kryesisht kosovare, në vitin 1877-78, në prag të themelimit të Lidhjes. Me mijëra fshatarë detyrohen të lënë trojet e tyre stërgjyshore e të jetojnë si endacakë të shpërndarë nëpër Kosovë e gjetkë. Sipas burimeve të ndryshme të kohës, por që e konfirmojnë edhe vargjet e këngëve, numri i tyre arrinte në dhjetra mijë. Tablonë dramatike të kësaj situatë kënga "*Muhaxhirët-o medet kah po shkojnë*", e paraqet me nota prekëse duke theksuar njëkohësisht edhe solidaritetin e popullsisë pritisë për t'u dhënë strehë këtyre njerëzve të çrrënjësuar nga toka mëmë: *Oh, kan' lan'tok-o bre kan' la' shpi-e.../ kan' lan bukën , o në çerep me hi-, / kan' lan' çorbën, në vegsh tuj zi-e;/ kan' lan'sofrën, o bre, të shtrueme n' shpi.../ Desin në bore, o bre, desin në shi,/ desin pleq, o bre, desin t'ri,/ desin gra, o bre , desin thmi...Bukën pa ngran', o bre, uj' pa pi./ kan'marr' udhën, o bre, për Allbani/ oh, udhën e gat', o bre, për Turki (Epika, 2: 237). Shpërngulja me dhunë e shqiptarëve të këtyre trevave u kthye në një tragjedi të vërtetë. Shumica e tyre u shpërdan, siç e thotë edhe kënga, viseve të Kosovës apo u drejtuan drejt Shqipërisë, Anadollit, etj. Kjo ngjarje bëri jehonë të madhe në atë periudhë dhe është e pasqyruar në një cikël të gjerë këngësh të krahinave të Kosovës e të Shqipërisë*

Lidhja e Prizrenit erdhi si një reagim i vendo-

sur, i organizuar e përfundimtar për të gjitha padrejtësitë që ishin ushtruar mbi trojet shqiptare dhe u përpoq të realizojë ëndrrën e rilindasve për të mos u pajtuar kurrë me robërinë e huaj. Aty shqiptarët, me krenari dhe guxim, shpallën përpara gjithë botës se ata ashtu siç dinë ta respektojnë lirinë e të tjerëve, dinë edhe ta mbrojnë me çdo lloj sacrifice lirinë dhe trojet e veta, gjuhën, traditat, kulturën që kanë zhvilluar në shekuj. Kuvendi Kombëtar bëri thirrjen për organizimin dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një front të vetëm për të siguruar të drejtat kombëtare. Fjalimi i zjarrtë i Abdyl Frashërit që u hap me fjalët: "Qëllimi i Kuvendit është që t'u presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t'i mbrojmë me gjak trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë ..." (Frashëri, 1979), u bë lajtmotivi i të gjitha përpjekjeve të popullit të trevave shqiptare. Ky moment dhe jehona që shoqëroi periudhën e mëvonshme përbën një objekt të rëndësishëm për epikën historike shqiptare. Mund të themi se shumë nga tekstet e këtyre këngëve qëndrojnë plot dinjitet krahas dokumenteve të shumta historike për të rindërtuar atë epokë të lavdishme dhe ato momente të vështira të kombit shqiptar. Dokumentet e shumta të firmosur nga banorët e trevave të ndryshme shqiptare në mbrojtje të vendimeve të Kuvendit të Prizrenit si ata të Shkodrës, Ulqinit, Tiranës, Prishtinës, Tivarit, Gjirokastrës, etj., gjithashtu shprehin fuqishëm indinjatën e thellë ndaj padrejtësive të bëra nga fqinjët e përkrahur nga "*shtatë krajlitë*", siç i quan me ironi poeti popullor Fuqitë e Mëdha. Në protestën e popullsisë së sanxhakut të Prishtinës drejtuar Kongresit të Berlinit kundër mizorive të kryera mbi popullsinë shqiptare prej ushtrive serbe, ruse, malazeze dhe bullgare, ndër të tjera shkruhet: "...Po qe se do të ndodhte flijimi i kombit tonë dhe ky do të bëhej viktimë e padrejtësive...ne do të vdesim me nder gjer te njeriu i fundit, që të mos jemi viktima të këtij nënshtrimi..." (Frashëri, 1979: 112) apo në Memorandumin e Lidhjes Shqiptare të krahinave të Jugut, drejtuar Fuqive të Mëdha, ku protestohet kundër aneksimit të disa krahinave në favor të Greqisë thuhet: "*Edhe sikur qeveria jonë të pranojë t'i lëshojë Greqisë një pjesë të territorit tonë, si Prevezën, Artën dhe Jani-*

nën, pikat strategjike dhe tregtare më të vlefshme për ekzistencën tonë të ardhshme, ne jemi megjithatë të vendosur të flijohemi të gjithë në altarin e atdheut dhe të mos i lëmë Greqisë veçse një fushë të madhe me kufoma, në të cilën do të rrjedhë gjaku i bijve tanë” (Xoxi, 1978: 1730).

Frymëzimi poetik popullor, në hapësirën e këngës së vet, përfshin një gjeografi të pasur e të larmishme që shkon nga vatra e Lëvizjes së Prizrenit; Kosova me krahinat e saj të Gjakovës, Prishtinës, Pejës, etj. e gjer në malësitë e Dukagjinit, Shkodrës, Dibërës, Krujës, Gjirokastrës e Çamërisë si dhe të gjitha trevave të tjera të banuara nga shqiptarët. Atdheu është një nocion i ngulitur mirë në ndërgjegjen e popullit, e si i tillë edhe në këngën dhe shpirtin e tij. Atmosfera e ndezur e kësaj periudhe vjen në cikle të shumta të këngëve të epikës historike në mënyrë të hapur e të drejtpërdrejtë, ku shprehet krahas krenarisë kombëtare edhe ndjenja e vetmohimit dhe qëndresës. Me një theks të veçantë këtë ndjenjë të thellë atdhedashurie dhe krenarie e ndeshim në këngën gjakovare, ku poeti popullor shpërthen: “Lumi un, mori Shqipri,/ Të bukur nam kam di për ti:/ Ke lidh besën për m’u shkri,/ Mos me lshu’ Plav’ e Guci!’/...Kem’ me ardh’ kem’ me qindrue,/ Krajl’ e mbretit kem’ me i diftue,/ tokn e babës s’ kem’ me lshue!” (Epika 2: 265).

Në cikle të tëra të epikës historike, që frymëzohen nga ky moment i rëndësishëm, ndihet protesta e hapur dhe denoncimi i fuqishëm ndaj padrejtësive, egërsisë dhe grykësisë të forcave shoviniste serbo-malazeze. Nuk ka ngjarje dhe momente që lidhen me fatin e trojeve shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve, në hapësirat e Perandorisë turke e më gjerë në kancelaritë e Fuqive të Mëdha europiane, traktate, konferenca e kongrese, mbretër, krajlër e diplomatë të huaj që të mbeten jashtë fokusit të këngës popullore. Poeti anonim, me mjeshtëri, finesë dhe guxim skalit gjithçka shpesh me saktësinë dhe formën e kronikës dhe me vërtetësinë e pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë në ngjarje. Aty gjejmë shumë informacion, detaje dhe hollësi por edhe përgjithësime të arrira artistike, karakterizime situatash e individualizime heronjsh, frymë të ashpër proteste e denoncim të padrejtësive, ku dallohen sidomos ciklet e këngëve

që i kushtohen luftës për mbrojtjen e Hotit e Grudës, Plavës e Gucisë apo ato për mbrojtjen e Ulqinit, etj. Kështu, në këngën “Me tok’ teme mbreti çka ka”, e cila i ngjan një balade të gjatë epike, i këndohet heroizmit të treguar nga luftëtarët shqiptarë për mbrojtjen e trojeve të pushtuara nga nga ushtria malazeze. Kënga sjell me detaje të hollësishme dhe me një ton rrëfimtar një nga momentet më dramatike të çështjes kombëtare si dhe shpalljen e kushtrimit popullor për të mbrojtur Plavën dhe Gucinë, të cilat iu dhanë padrejtësisht Malit të Zi nga Kongresi i Berlinit. Popullsia e këtyre krahinave, nën udhëheqjen e prijësve popullor Kadri Bajri e Jakup Ferri, i dolën armikut përballë, të ndihmuar edhe nga krahina të tjera shqiptare nga e gjithë Kosova, Shkodra, etj., duke u bërë një barrikadë e pakapërcyeshme për të mos e lejuar ushtrinë malazeze të depërtojë në thellësi të tokave shqiptare. Për luftëtarët shqiptarë nuk ka gjë më të shtrenjtë se sa toka e mëmëdheut të tyre, prandaj siç e thotë kënga: “... tokën e babës s’ mujm’ me e lshue, / rob askujt nuk mujm’ me u ba./ Në luftën për mbrojtjen e Ulqinit, Forcat e Lidhjes u bënë një qëndresë heroike trupave turke në nëntor 1880. Ata u ndihmuar edhe nga forca vullnetare të ardhur nga krahina të tjera të Shqipërisë si Dul Salih nga Shkodra e Met Murati nga Kavaja. Në këngën kushtuar këtij të fundit mes të tjerash thuhet: “Pushka e parë që bëri bam, / Met Murati në istikam... / Met Murati nga Kavaja, / me njiqind vjen nga kazaja; / me fitu, o me vdek’ t’ tanë, / për liri e për vatan” (Epika 2: 297). Edhe pse qeveritarët turq bënë gjithçka për t’i bindur shqiptarët, siç ndodhi me anëtarët e degës së Lidhjes të Shkodrës, duke përdorur krahas forcës e presionit edhe premtimet, rryshfetet, korrupsionin, etj., që ta dorëzonin pa luftë Ulqinin, ata e hodhën poshtë me përbuzje çdo ofertë poshtërese duke vënë në dukje se ky ishte vullneti i popullit. Ministri i Luftës u detyrua të flasë vetë në telefon me anëtarët e degës së Lidhjes së Shkodrës duke u bërë premtime të shumta. Kënga popullore e ka fiksuar edhe këtë moment: “I thot Shkodra: -Nuk nigjojm! / Të shtatë kralet me ba urdi! / Pa krisë pushka nuk e lshojmë!” Rezistenca e tyre la përshtypje të thella e të pashlyeshme në opinionin e gjerë të kohës, edhe pse shqiptarët e humbën Ulqinin: “Shkruien gazetata anë

për anë, /vojti xhevopi ndër shallarë: /-Krisi pushka në istikam, /duel mileti me faqe të bardhë!"

Tablotë dhe dëshmitë që vijnë prej krijimeve popullore janë të përshkruara me origjinalitet dhe thjeshtësi dhe të lënë mbresa të thella. Nëpërmjet tyre shprehet qëndresa dhe stoicizmi popullor përballë egërsisë së pushtuesve turq, serbë, malazesë, bullgarë, etj., si dhe intrigat e Fuqive të Mëdha që i përdorën trojet shqiptare si monedha shkëmbimi për të kënaqur orekset e fqinjëve. Muza popullore shpërthen herë me forcën e kronikës e herë përmes përgjithësimeve të fuqishme artistike duke sjellë portrete heronjsh që me aktet e tyre sublime lartësohen plot dinjitet përballë figurave cinike të pushtuesve. Në kronikën e këngëve epike kalohet nga paraqitja e betejës së përgjakshme të luftës trup me trup për mbrojtjen e Ulqinit, në përpjekjet e organizuara nga Lidhja e Prizrenit për të përzënë qeveritarët turq në Prishtinë, Mitrovicë, etj. Poeti popullor e paraqet me nota të gjalla epike tablonë e betejës së Shtimljes, ku turqit lanë 1800 të vranë, ndërsa nga shqiptarët mbetën në fushën e betejës rreth 800 vetë. Vetëm rreth 3000 shqiptarë të armatosur me pushkë me çark u ndeshën me ushtrinë turke që ishte shumë moderne për kohën, e armatosur deri në dhëmbë me të gjitha llojet e armëve që disponoheshin në atë kohë, deri edhe bateri malore dhe topa Krup. Një pamje madhështore vizaton poeti popullor në këngën me titull "*Në fush' t' Kosovës a lidh jezeri*" duke kaluar nga një karakterizim i shpejtë e i përgjithshëm i situatës në përqëndrimin maksimal të veprimit dhe paraqitjen e dramës së heroit. Hysen Zmajli endet nëpër fushën e Shtimljes majë kalit në kërkim të varrit të birit të tij të vetëm, bashkëluftëtarit të Mic Sokolit, rënë në fushën e betejës kundër armiqëve: *Zmajl Hyseni ish kan' drangue: /-Nan' e bab', ju met' pa mue / -Nan' e bab', ju met' pa mue / nan' e bab' ju met' pa djalë, / n' fush' të Shtimljes sot jam nalë, / mos ma leni gjakin pa marrë. /Hysen Zmajli i hypi atit, / ia dha malit ia dha shpatit, / me gërgue vorrin e djalit. / -Kam desht' djalin me e martue, / krushqit thirr', vadja m'ka shkue! / Zmajl Hyseni hup' e tretë / kurrkush vorrin s'ia ka gjetë!" (Epika 2: 305). Kënga është konceptuar si një dialog mes babait dhe birit të rënë në fushën e betejës. Përmbi dhimbjen dhe tragjedinë njerëzore lartësohet krenaria dhe dinji-*

teti i atij që ka kryer detyrën ndaj atdheut. Për trimat shqiptarë që bien për mbrojtjen e trojeve dhe nderin e atdheut, nuk ka vdekje, për ta vargjet e këngës së mësipërme shërbejnë si një kurorë e artë dashurie dhe pavdekësie.

Përpjekjet e shqiptarëve për autonomi dhe për mbrojtjen e trojeve stërgjyshore, të cilat u ngritën në një lartësi të paparë në periudhën e Lidhjes, siç dihet, ndeshën jo vetëm në një forcim të dhunës nga ana e Turqisë ndaj krerëve të saj, por edhe në një intesifikim të propagandës shoviniste të fqinjëve për ta diskretituar dhe injoruar atë. Por siç pranohet edhe nga diplomatët të huaj të kësaj kohe: "*Shqipëria ...nuk qëndron as jashtë botës, as jashtë historisë dhe se lëvizjet dhe luftërat e saj nuk janë as kryengritje të "egrish" kundër qytetërimit, si e paraqesin disa, as fryt i qëllimeve të agjentëve të huaj siç e paraqesin të tjerët"* (Xoxi, 1978: 128). Shqiptarët, në të vërtetë, i treguan botës se në kundërshtim me deklaratat armiqësore, në të cilat mohoheshin aftësitë e tyre për të qeverisur vendin, ata ishin të gatshëm jo vetëm ta mbronin truallin e tyre, por edhe që nëpërmjet autonomisë ta çonin atë drejt rrugës së përparimit e progresit. Dukeqënëse për qeverinë osmane veprimtaria e Lidhjes përbente një fakt të papranueshëm, me miratimin e Sulltanit kundër saj u nis në fillim të prillit 1881 një ushtri e madhe me rreth 15 batalione me asqerë të "*zinj*", për ta mposhtur rezistencën e organizuar prej saj. Në këngën "*Shum' asqer po qet pamporri,*" nga njera anë jepet mizëria e trupave armike të ekspeditave famëkeqe të drejtuara nga Dervish pasha që me zjarr dhe hekur kërkon të nënështrijë qëndresën shqiptare si dhe urrejtja e pakënaqësia e popullit për këtë dhunë të paparë: "*Shum' asqer po qet pamporri, / tan po i qet ma zi se korbi! / Dervish pasha prej Stambolli..."* Në anën tjetër ravijëzohet heroizmi popullor, ku dallohen trima si Mic Sokoli e Ali Ibra, etj., që në këto situata tragjike të fatit të kombit dhe të jetës së tyre, bashkojnë zemrat përballë topave të armikut. Edhe vdekja e tyre është madhështore, është pavdekësi që e kapërcen vdekjen fizike: "*Mic Sokoli ban me dorë; / -Besa, shok, nuk muj me folë, / se m' ka ra do gjak në gojë, / se m' ka ra do gjak në bark, / shtat martina i kam në shtat"* (Epika 2: 303). Heroizmi i tyre është konkret dhe paraqitet në vargjet e këngës me nota

prekëse, reale: *"Mic Sokoli po bërtet, / Ali Ibrën po e thërret: / -Merr bajraqtet, hajde shpejt, / na rrethoi asqeri mbret! / Ali Ibra në vrac të zi, / po i shko gjaki për zinxhi..."* Guximi dhe vendosmëria e luftëtarëve shqiptarë për t'u përballur me taborret e ushtrisë turke deri në pëleshje trup më trup u finalizua me aktin heroik të komandantit trim Mic Sokoli, që u hodh me gjoksin e vet mbi grykën e topit për t'u bërë simbol i pavdeksisë dhe qëndresës shqiptare. Kënga popullore e ka gdhendur me vargje të arta aktin e tij, duke e dhënë atë përmes një përfytyrimi të bukur artistik dhe në përmasa sa fantastike aq edhe reale: *"Mic Sokolin e vrau reja, / E vrau reja, e vrau moti, / E vrau Dervishi me gjyle topi.* Kënga tjetër që na afron një pamje realiste madhështore të qëndresës dhe heroizmit përballë terrorit armik është ajo me titull: *"Kam dhan' jetën për Shqipni"*, kushtuar Sef Koshares, njerit prej udhëheqësve të forcave të armatosura të Lidhjes, i cili u la tri ditë i varur për t'i futur tmerrin popullit: *"Sef Kosharja, trim i fisit, / hije të paska maja e lisit! / - Hije m' ka o djelm e mi', / kam dhan' jetën për Shqipni."* Këto vargje të këngës popullore do të thoshim se janë epigrafi më i arrirë e më i denjë për heroin. Dervish Pasha, ky xhelat gjakatar dha urdhër që shqiptarët e vrarë të mos varrosen, me qëllim që të ngjallej panik sidomos në radhët e drejtuesve të Lidhjes. Të flijohesh për atdheun është ideali më i lartë, më i bukur e më sublim. i jetës, ndaj edhe muza popullore një vdekje të tillë e cilëson të hijshme, edhe pse tragjike.

Epika historike sjell një informacion të bollshëm e një pasuri artistike edhe për një nga figurat më të shquara të prijësve popullor, trimin gjakovar Sulejman Vokshin, që u bë shpirti dhe zemra e Lidhjes së Prizrenit. Aftësia e tij e veçantë si ushtarak e komandant i zoti përballë një ushtrie të armatosur gjer në dhëmbë, intelijenca dhe shpirti guximtar përballë situatave të vështira, jepen me detaje, fakte e hollësi në disa këngë epike. Vendosmërinë dhe shpirtin e paepur të tij populli e paraqet nëpërmjet vargjeve: *"Zo Dervishi ku a vetë? / Pesë zabitë ia lashë pa jetë / Du'n' Dervishin me u zatetë... / t'ja qesë zemrën në ledinë"* ku shprehet guximi për t'u ndeshur e hakmarrë edhe mbi komandantin e operacinit turk. Aktet e guximshme në beteja, kalimet e vështira nëpër shtigjet e

ngushta malore për të zvogëluar efektin e ushtrisë turke, aftësia e veçantë për t'u fshehur në çdo çast armikut e bëjnë atë një figurë sa reale aq edhe të veshur me tisin e legjendës. Populli ka krijuar me mjeshtëri të veçantë një përfytyrim të bukur artistik në lidhje me heroin. Edhe kur armiku mendon se e ka fituar luftën dhe e ka shtypur Lidhjen, ai me bashkëlufëtart e vet të paepur qëndrojnë në lartësitë e Gjakovës, midis reve të bardha të bjeshkëve, të gatshëm për t'u ndeshur me pushtuesit gjer në vdekje: *"Ç' po pëvet Dervish Pasha: / - Zo' ku rrin Sulejman aga? / -Në ato bjeshkë, te retë e bardha... / Dervish Pasha po pëvet: / -Zo' mileti ku u tret? / -Q' atje nelt', ku zbardhin ret'..."*

Në këtë pasuri të begatshme të epikës historike në dekadat e fundit të shek. XX, populli nuk u këndon vetëm heroizmit në beteja, por edhe zgjuarësisë dhe vizionit politik e kombëtar të udhëheqësve të Lidhjes si dhe mendimit të përparuar të Rilindjes Kombëtare. Madje në vargjet e këtyre këngëve vihet re një sintezë artistike dhe filozofike për epokën, rrethanat dhe fatin tragjik të shqiptarit, që është shumë e afërt me vizionon e rilindasve. *"- Bini, djem t' desim me nerë / Se shqiptari dy gëzime ka, / një kur le dhe n'luftë me ra"*, thuhet në vargjet e këngës popullore. Ndërsa Jani Vreto në këtë moment të rëndë të kombit shkruan: *"Ç'na vlen jeta nën ca mote robërie përpara vdekjes së ndershme, por me liri..., nuk duhet të mendojmë qysh të rrojmë, por qysh ta mbrojmë e të vdesim me nder"* (Xoxi, 1978: 137). Në këngët epike të kësaj periudhe, jo vetëm himnizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte lufta dhe përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe heroizmi për mbrojtjen e trojeve, por u këndohet me dashuri e respekt themeluesve dhe udhëheqësve të saj. Përmenden cilësitë e larta të karakterit të tyre si p.sh *"Ymer Prizreni trim shqiptar"*, apo Abdyl Frashëri udhëheqësi i urtë i Lidhjes Shqiptare që sipas këngës popullore është kudo i pranishëm në kuvende kombëtare e ndërkombëtare duke ngritur zërin e protestës popullore ndaj padrejtësive, që "shkrin" gjithë pasurinë e vet, *"një barrë flori"* për Shqipërinë dhe me guxim hyn gjer në zyrën e kancelarit gjerman Bismark në Berlin duke i shpalosur zërin e protestës ndaj padrejtësive në emër të gjithë bashkëatdhetarëve të vetë. Ndërsa armiqtë e tro-

jeve shqiptare pushtuesit e egër e tinzarë, stigmatizohen e ndëshkohen me tallje, shpoti e sarkazëm. Përmbi ujditi e "*shtatë krajlivë*" apo fqinjëve të pabesë ngrihet gjithmonë si një teh i mprehtë shpate vargu i këngës popullore: "*Kral Nikolla i Cetinës, / t'jep xhevap gryka e martinës.*"

PËRFUNDIM

Mund të themi se vargjet e këngëve epike të kësaj periudhe shprehin një sintezë ideo-artistike të vetë epokës që ato pasqyrojnë, të rrethanave historiko-kombëtare dhe dramaticitetit që ato bartin. Ato dallohen për karakteristika dhe tone epiko-retorike dhe në përgjithësi i bashkon një bosht i vetëm tematik që lidhet me çështjen kombëtare dhe frymëzohen nga ndjenja e atdhedashurisë. Gjuha e epikës historike në përgjithësi është e thjeshtë, por ka një përpunim në një shkallë të lartë të shprehjes artistike dhe në këtë drejtim mund të themi

se ajo përbën një pasurim të gjuhës kombëtare. Në stilin poetik dallohet ekspresiviteti i shprehjes, shija e hollë artistike, eleganca dhe ritmi i gjallë, ku përmes plasticitetit të rrëfimit, vizatimit realist të rrethanave, karakterit të heronjëve si dhe paraqitjes së aksionit të tyre, shprehet fryma e epokës.

BIBLIOGRAFI

- FRASHËRI, K. (1979), *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Shtëpia Botuese "8 nëntori", Tiranë.
- XOXI, K. (1978), *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Shtëpia Botuese "8 nëntori", Tiranë.
- GJURMIME ALBANOLOGJIKE, 33-34 (Folklor etnologji), Prishtinë 2005.
- EPIKA HISTORIKE, Vëllimi 1, Tiranë 1983.
- EPIKA HISTORIKE, Vëllimi 2, Tiranë 1982.
- EPIKA HISTORIKE, Vëllimi 3, Tiranë 1990.
- FJALË të urta të popullit shqiptar, Tiranë 1983.
- LUFTA e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar, 1918-1920 (Përmb. dok.), Tiranë 1975.
- STUDIME HISTORIKE, nr. 4, Tiranë, 1987.